

**Kufizimi i Privatësisë  
në Emër të Sigurisë**

**EncroChat**  
**në dorë të Policisë**



## **RAPORT MONITORIMI**

**Dhjetor 2023**



**AUTOR  
DRIOLA KRAJA**

**QENDRESA  
QYTETARE**



**NED**

**NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY**

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

## Përmbajtja

Hyrje .....	1
EncroChat-i dhe komunikimet e koduara .....	1
Shqipëria, EncroChat dhe SkyECC .....	2
Puna e deritanishme nga SPAK për arrestimin e trupave të Policisë .....	4
Përpjekjet botërore në zbulimin e mesazheve të enkriptuara.....	5
Përfundime .....	7
Rekomandime.....	8
Bibliografia.....	10

## Hyrje

Krimi i organizuar në Shqipëri ka qenë dhe është kryefjala e shtetit gjatë tentativave për ndërtimin e një shteti të së drejtës. Gjatë përsiatjeve të vazhdueshmë të ndërkombëtarëve për të vënë nën kontroll krimin e organizuar, dilet lehtësisht në përfundim që ky fenomen është problem alarmues edhe për shtetet anës bregut.

Vetë Ministria e Brendshme, në objektivin 1.5 të Planit të Strategjisë Kundër Krimin të Organizuar shprehet se: "Krimi i organizuar është një sfidë që i kalon kufijtë e territorit shqiptar. Shumë grupe kriminale shqiptare e ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë."<sup>1</sup>

Përveç planeve tona strategjike në luftën e krimin, ne dhe ndihmë informatore apo institucionale nga vendet e tjera apo struktura botërore kundër krimin. Europol, operon si një qendër për analizën e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me krimin e organizuar, trafikimin e njerëzve, korrupsionin, dhe sfidat tjera të sigurisë. Bashkëpunimi ngushtë me forcat e tjera të rendit, organet e sigurisë dhe agjencitë relevante brenda dhe jashtë BE-së është thelbësor për arritjen e qëllimeve.

Më 27 Qershor, 2023, Europol nxori lajmin e bujshëm me shifra marramendëse të një operacioni antikrim që kishin bërë në Europë, atë të zbulimit dhe zhbllokimit të mesazheve të enkriptuara, të aksesueshme përmes aplikacioneve EncroChat dhe SkyECC.

Në këtë raport, do shohim të dhënat që Shqipëria dhe Ministria e Brendshme ka marrë nga ky operacion, dhe se cilët kanë qenë agjentët kriminal të infiltruar në Policinë e Shtetit.

---

<sup>1</sup> VENDIM Nr. 1140, datë 24.12.2020 fq. 13

## EncroChat-i dhe komunikimet e koduara

Telefonat EncroChat u promovuan duke siguruar anonimitet të plotë, diskrecion absolut dhe gjurmueshmëri minimale për përdoruesit. Ata ishin të pajisur me veçori të krijuara për të lehtësuar fshirjen automatike të mesazheve, së bashku me një kod PIN specifik për fshirjen e shpejtë të të gjitha të dhënave në pajisje. Ky funksion i lejoi përdoruesit të eliminonin menjëherë mesazhet potencialisht komprometuese, veçanërisht gjatë momenteve të tilla si arrestimet e policisë.

Për më tepër, rishitësi ose zyra e ndihmës kishin aftësinë për të fshirë nga distanca pajisjen EncroChat. EncroChat shiti kriptofona<sup>2</sup> për afërsisht 1000 euro secili në shkallë ndërkombëtare. Ofroi gjithashtu abonime me mbulim global me një kosto prej 1500 euro për një periudhë gjashtëmujore, me mbështetje 24/7.<sup>3</sup>

Sipas një raporti të majit 2019 nga Gloucester Citizen, EncroChat fillimisht u zhvillua për "të famshëmit e shqetësuar për hakimet e mundshme të bisedave telefonike".<sup>4</sup> Në rastin e vrasjes së vitit 2015 të mafiozit anglez Paul Massey, autorët përdorën një shërbim të ngjashëm që ofronte telefona të koduar BlackBerry. Pas kompromentimit të serverit të tyre nga policia holandeze dhe kanadeze në vitin 2016, EncroChat u shndërrua në një alternativë të miratuar gjerësisht në mesin e kriminelëve për shkak të shërbimeve të saj të fokusuara në sigurinë në periudhën 2017-2018.

Themeluesit dhe pronarët e EncroChat mbeten të paidentifikuar, por aplikacioni përjetoi rritje të shpejtë gjatë ekzistencës së tij katërvjeçare e gjysmë, duke grumbulluar rreth 60,000 abonentë në kohën e mbylljes së tij në qershor 2020.<sup>5</sup> Sipas Policisë Kombëtare Franceze, 90% e abonentëve ishin të përfshirë në aktivitete kriminale dhe Agjencia Kombëtare Britanike e Kriminimit (NCA) nuk raportoi asnjë provë për jokriminelë që përdorin shërbimin.

---

<sup>2</sup> Celularë të posaçëm për kodimin e informacionit.

<sup>3</sup> [Dismantling encrypted criminal EncroChat communications leads to over 6 500 arrests and close to EUR 900 million seized](#). Europol

<sup>4</sup> ["The £3,000 a year encrypted mobiles with kill pills used by gangs"](#). Gloucester Citizen.

<sup>5</sup> ["EU authorities penetrate phone network in huge organised crime sting"](#). Euronews.

## Shqipëria, EncroChat dhe SkyECC

Pas një kalvari të gjatë përpjekjesh për të delegitimuar përgjimin e bërë nga aplikacionet e koduara, Gjykata Evropiane pritet të marrë një vendim në fund të vitit 2023 për ligjshmërinë ose jo të përgjimeve të bëra nga Europoli.<sup>6</sup> Gjithsesi, duhet thënë se shumë shtete e kanë pranuar tashmë si prova shumë të rëndësishme të gjitha mesazhet e koduara me rrjetin EncroChat dhe SkyECC, por dhe kanë vendosur precedent për metoda të tjera që mund të dalin në pah më vonë.<sup>7</sup>

Shqipëria, ndërkohë, është në hapat e parë të spastrimit dhe arrestimeve të bëra në kuadër të këtyre bisedimeve. Kjo për shkak të zgjatjes së hetimeve dhe mbingarkesës që këto mesazhe kanë sjellë për Prokurorinë e Posaçme, SPAK. Spastrimi i rrugëve të qytetit nga bandat kriminale ka një pikë thelbësore shumë jetike si spastrimi i punonjësve në administratë shtetërore ose institucione të tjera shtetërore, që jua kanë mundësuar fshehjen e krimeve deri tani. Policia qëndron në bazë të këtyre institucioneve dhe për rrjedhojë, vëmendja u është hedhur atyre kohëve të fundit, në prag arrestimesh të bëra për krimin e organizuar.

Taulant Balla, ministër i Ministrisë së Brendshme, në fillim të Tetorit, bëri deklaratë për mediat pikërisht me këtë fenomen: *“SPAK po zhvillon hetime të thelluara dhe besoj se shumë shpejt do të kemi disa rezultate konkrete, ku do të vetëpastrohet jo vetëm policia prej tyre, por edhe shoqëria. Vetëpastrimi është i rëndësishëm, dhe pastaj që mbi bazën e këtij lloj vettingu të ri në Policinë e Shtetit, të krijojmë një strukturë të re të Policisë së Shtetit [...]”,* u shpreh ai..

Në fakt, vetting-i u policisë së shtetit, së cilës Z. Balla i referohet si “Vetëpastrim”, nuk duhet bërë nga prokuroria e posaçme, por nga vetë policia, me anë të politikave që ministri apo institucione relevante ndërmarrin. Sigurisht, që agjencitë e tjera shtetërore nuk mund të nisin një procedim penal, pasi AMP (Agjencia e Mbikëqyrjes Policore) ka funksionin e një policie gjyqësore, që është në varësi të Prokurorit.<sup>8</sup>

<sup>6</sup> [“Will the “Sky” interceptions be accepted as evidence? This is when the European Court decides”](#) Vox News Article

<sup>7</sup> [“EncroChat Turns into a Case for the CJEU”](#) Eucriim

<sup>8</sup> LIGJ Nr.128/2021 PËR AGJENCINË E MBIKËQYRJES POLICORE

Ama, Ministri u referohet atyre në fjalën e tij për spastrimin e Policisë nga përdoruesit e EncroChat dhe SkyECC:

*“Ka pasur dhe ka punonjës që janë përfshirë në botën e krimit. I kam kërkuar Policisë dhe AMP, duke qenë se jemi edhe vetë në kontakt me Europol, që të kemi informacion sa më shpejt të jetë e mundur, për çdo punonjës që do rezultojë që të ketë pasur akses në këto rrjete komunikimi EncroChat apo Sky do përjashtohet nga policia edhe në rast se në ato komunikime nuk rezulton të ketë aktivitet kriminal. Fakti që ka akses në rrjet të tillë, kjo është pjesë e angazhimit tim që lidhet me kodin etik në policinë e shtetit, ndalohet që një punonjës të ulet në kafe apo restorant me persona me background (sfond) kriminal, kjo vlen edhe për takimet virtuale me krimin. Ky rregull do të zbatohet për të gjithë. SPAK po heton mbi gazën e të dhënave të vënë në dispozicion nga Europol dhe do kemi të dhëna konkrete”.*

Nga kjo deklaratë kuptojmë dy pika kyçe të politikëbërjes dhe vetëpastrimit të Policisë, ku së pari, mjafton sinjalizimi nga Europol dhe vendimi për pushim nga puna në rradhët e institucionit është i garantuar, dhe së dyti, do jetë Agjencia ajo që do jetë sinjalizues i Ministrisë së Brendshme për dhënien e vendimit për pushim nga puna. Kështu, krijohet nja organizim disi i hallkëzuar, ku AMP luan rolin dhe të administruesit, por dhe të proceduesit penal. është e paqartë nëse këto masa do merren pas hetimit në tërësi, apo do ndodhin në momentin e marrjes së informacionit për përfshirjen e Policëve në krim, pasi në media thuhet e para, por në prapaska, puna ndryshon.

Thënë kjo, masat që ka marrë Ministria e Brendshme janë inekzistente, deri tani. Në një letër për kërkesë informacioni drejtuar Ministrisë së Brendshme, protokolluar me datë 01/11/23, ajo shprehet se *“Policia e shtetit në bashkepunim me Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, SPAK, po kryen të gjitha veprimet e nevojshme për të konkluduar lidhur me këtë çështje.”* Kërkesa për informim ishte nisur me qëllimin e njohjes së të gjitha masave që janë marrë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, nga dalja në pah e aksesit të tyre në EncroChat dhe SkyECC.

Në mungesë të informacioneve të detajuara, duket se nuk ka pasuar hetime të mjaftueshme për të nxjerrë në pah masat e marrë nga Ministria e Brendshme ndaj përfshirjes së punonjësve të Policisë së Shtetit në këtë çështje. Ky mungesë transparence nxit një ndjenjë të pasigurisë dhe ka hapësirë për dyshime rreth përpjekjeve reale për të

adresuar këtë çështje serioze të përdorimit të aplikacioneve të koduara nga personeli i forcave të rendit.

Megjithatë, ky shembull i qartë i moskongruencës del nga fakti se në letër, Ministria e Brendshme shprehet se SPAK, e jo Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, do të ketë përgjegjësinë për të konkluduar lidhur me masat që do të merren ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit në lidhje me përdorimin e aplikacioneve të koduara. Ky dallim thelbësor shkakton dyshime mbi kredibilitetin dhe qartësinë e strategjisë së vetëpastrimit të Policisë, pasi qëllimi i njësimimit të sinjalizimit dhe vendimit për pushim nga puna duket të ketë ndryshuar në rrugën nga Ministria e Brendshme drejt SPAK-ut, duke lënë vend për moskuptim dhe mosrealizim të qëllimit të parashikuar për vetëpastrim. Pushimet nga puna nuk do jenë të nevojshme nëse kryhen arrestime nga Prokuroria e Posaçme.

## Puna e deritanishme nga SPAK për arrestimin e trupave të Policisë

Prokuroria e Posaçme (SPAK) është vënë në lëvizje për të hetuar thellësisht përdorimin e aplikacioneve të enkriptuara, siç janë SkyECC dhe Encrochat, në kontekstin e kriminalitetit të organizuar. Operacioni "Metamorfoza" shënon një angazhim të fortë të SPAK për të identifikuar dhe shpërthyer strukturat komplekse të lidhjeve dhe marrëdhënieve nënshtruese të përfshira në përgatitjen e tentativave për vrasje.

Gjatë këtij operacioni të madh, figurat e njohura si Pëllumb Gjoka, Oltion Bistri dhe Xhevahir Lita janë ndaluar. SPAK ka lëshuar 11 urdhër-arreste dhe ka nisur hetimet në lidhje me 56 punonjës policie për dyshime të pjesëmarrjes së tyre në këto struktura kriminale.

Me një shtrirje të gjerë, operacioni ka shënuar arrestimin e disa figurave të njohura, duke përfshirë biznesmenin Pëllumb Gjoka, ish-shëfimin e operacionales Oltion Bistri, dhe prokurorin e Kukësit, Xhevahir Lita. Përveç urdhër-arrestit, SPAK ka hedhur nën hetim 56 punonjës policie, theksuar lidhjen e tyre me këto struktura të kriminale.

Deri më tani, janë arrestuar dhe katër persona, përfshirë ish-zëvendës drejtorin e Policisë së Tiranës, Erzen Breçanin, dhe shëfimin e Krimeve të komisarati Nr. 6 në Tiranë, Dedan Gjonin. Ata janë ndaluar në një aksion spektakolar pranë stadiumit 'Air Albania', ku kishin blerë bileta për të ndjekur ndeshjen e kombëtares me Ishujt Faroe. Përveç tyre, në pranga kanë rënë edhe Besmir Murati dhe Bujar Germizi, njohur si Ajeti.

Jonida Babameto, oficer e Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit, është një prej punonjësve të policisë që është shoqëruar në kuadër të këtij hetimi.

Akuzat që rëndojnë mbi të arrestuarit përfshijnë pastrimin e parave, organizimin e një grupi të strukturuar kriminal, trafikun e drogës, sigurimin e kushteve për kryerjen e vrasjeve, shpërdorimin e detyrës dhe përkrahjen e autorit të krimit. Ky operacion shënon një fazë të rëndësishme në përpjekjet e autoriteteve shqiptare për të luftuar kriminalitetin e organizuar dhe për të siguruar rendin dhe ligjin në vend.

## Përpjekjet botërore në zbulimin e mesazheve të enkriptuara

Zbulimi dhe arrestimi i figurave të përfshira në kriminalitetin e organizuar nga vende të ndryshme në botë ka shpallur një përpjekje të koordinuar dhe të përbashkët për luftën kundër këtij fenomeni global. Ndër hapat dhe përpjekjet e ndërmarra nga vendet e ndryshme, disa aspekte shquhen:

### 1. Ndarja e Informacionit dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar:

Vendet kanë intensifikuar bashkëpunimin dhe ndarjen e informacionit inteligjent për të identifikuar dhe ndaluar individët e përfshirë në krimin e organizuar. Kjo ka shënuar një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një mjedisi të përbashkët kundër kriminalitetit global.

### 2. Përdorimi i Teknologjisë dhe Aplikacioneve të Enkriptuara:

Autoritetet janë përpjekur të ndërmarrin hapa të specializuara për të depërtuar dhe zbuluar përdorimin e teknologjisë së avancuar dhe aplikacioneve të enkriptuara nga organizatat kriminale. Hetimet janë përqendruar në shkatërrimin e rrjetave të komunikimit të fshehura dhe të sigurta.

### 3. Operacione të Përbashkëta dhe Megaoperacione:

Shumë vende kanë koordinuar operacione të përbashkëta, duke përfshirë një numër të madh të agjentëve dhe burime të specializuara. Megaoperacione si "Metamorfoza" në Shqipëri janë shembuj konkret



të përpjekjeve të koordinuara për të kapur strukturat e përfshira në krime të organizuara.

#### 4. *Hulumtimi i Pasqyrave Financiare:*

Një pjesë e përpjekjeve janë përqendruar në monitorimin dhe hetimin e lëvizjeve financiare të dyshimta që lidhen me kriminalitetin e organizuar. Për këtë qëllim, është përdorur bashkëpunimi me institucione financiare ndërkombëtare dhe monitorimi i transferimeve të parave.

#### 5. *Legjislacioni dhe Korniza Ligjore:*

Disa vende kanë rishikuar dhe përmirësuar kornizat ligjore për të adresuar sfidat e reja që dalin nga krimi i organizuar. Kjo përfshinë hartimin e ligjeve specifike dhe të rrepta të reja që mundësojnë hetimet dhe ndjekjen efikase të këtij lloji kriminaliteti.

#### 6. *Rritja e Kapaciteteve të Agjencive të Sigurisë:*

Përmirësimi i kapaciteteve teknologjike dhe operacionale të agjencive të sigurisë është një tjetër hapat e ndërmarrë nga shumë vende për të bërë hetimet dhe ndjekjen më efikase të personave të përfshirë në krimin e organizuar.

Këto përpjekje të koordinuara përbëjnë një pjesë të përpjekjeve ndërkombëtare për të përballuar sfidat e kriminalitetit të organizuar dhe për të siguruar drejtësi ndërkombëtare.

E çuditshme dhe padyshimërisht e padrejtë është që policia e vendeve të tjera ka vënë një theks të madh në zbulimin e komunikimeve kriminale, ndërsa në Shqipëri, pavarësisht premtimeve nga Ministri i Brendshëm, nuk janë ndërmarrë masat administrative e ligjore të nevojshme. Kjo jo vetëm që shfaq një mungesë koordinimi dhe përkushtimi ndaj luftës kundër kriminalitetit të organizuar, por edhe hedh dyshime serioze mbi integritetin dhe pavarësinë e strukturave të policisë në vend.

Në një situatë kur policia është e përfshirë në aktivitete kriminale dhe ka postet më të larta në hierarkinë e polisë, kjo përforcon ndjenjën e padrejtësisë dhe shqetësimin për sundimin e ligjit. Është e pamundur të

kuptohe si persona me detyra zyrtare mund të përfshihen në veprimtari të tilla pa u hetuar dhe ndëshkuar në përputhje me ligjin.

Mungesa e masave efikase dhe të menjëhershme në Shqipëri për zbulimin dhe ndëshkimin e tyre nuk bën vetëm që të krijojë një vakum të sigurisë, por gjithashtu rrit nivelin e pasigurisë dhe mosbesimit të qytetarëve në institucionet e shtetit. Në një kohë kur bashkëpunimi ndërkombëtar është i rëndësishëm për adresimin e sfidave globale të kriminalitetit, kjo dukuri bën që Shqipëria të kthehet në një pikë fokale e shqetësimeve në fushën e sundimit të ligjit.

## Përfundime

### 1. Ndërveprimi Ndërkombëtar dhe Ligjshmëria e Përgjimeve:

- Gjykata Evropiane pritet të vendosë në vitin 2023 lidhur me ligjshmërinë e përgjimeve të bëra nga Europol nëpërmjet aplikacioneve të koduara. Disa shtete kanë pranuar këto përgjime si prova të rëndësishme, duke vendosur precedent për masat e tjera.

### 2. Vetting dhe Spastrimi në Shqipëri:

- SPAK ka nisur hetimet dhe operacionin "Metamorfoza" në Shqipëri për të përpunuar arrestime dhe pastruar strukturat prej përfshirjeve në krimin e organizuar. Ky proces përfshin edhe një vetting të policisë për të hequr ata pjesëtarë të përfshirë në krim.

### 3. Ministri Balla dhe Rruga drejt Vetëpastrimit:

- Ministri i Brendshëm, Taulant Balla, ka shprehur angazhimin për vetëpastrim dhe sigurimin e informacionit nga Europol rreth përdoruesve të aplikacioneve të koduara. Rruga drejt një sistemi të ri të policisë është theksuar.

- Ministri Balla ka theksuar kujdesin për kodin etik në policinë e shtetit, duke ndaluar qasjen e punonjësve në rrjetet e komunikimit të përdorura nga kriminelët. Kjo shënon një përpjekje për të mbajtur standarde të larta etike në forcat e rendit.

### 4. Roli i SPAK dhe Prosesi i Hetimit:

- SPAK është në krye të hetimit për të adresuar përdorimin e aplikacioneve të enkriptuara. Operacioni "Metamorfoza" ka çuar në

arrestimin e disa figurave të njohura dhe hetimin e thelluar të punonjësve të policisë për përfshirje në krimin e organizuar.

#### 5. Mungesa e Masave Efikase dhe Transparenca:

- Në Shqipëri ka pasur mungesë të masave të menjëhershme dhe transparencës në procesin e pastrimit. Kjo ka lënë hapësirë për dyshime dhe ka ulur besimin e publikut në institucionet e shtetit.

#### 6. Ndikimi i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Masat Vendore:

- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe masat lokale janë të rëndësishme në adresimin e sfidave të kriminalitetit të organizuar. Ndërsa njësitet lokale janë të përfshira në hetimet dhe pastrimin, bashkëpunimi me Europol dhe përdorimi i informacionit nga ky burim janë kritike.

#### 7. Përshkrimi i Operacionit "Metamorfoza" dhe Akuzat:

- Operacioni "Metamorfoza" ka shënuar një fazë të rëndësishme në përpjekjet për të luftuar kriminalitetin e organizuar në Shqipëri. Akuzat përfshijnë pastrimin e parave, trafikun e drogës, dhe sigurimin e kushteve për vrasje. Arrestimet dhe hetimet vazhdojnë.

## Rekomandime

#### 1. Forcimi i Bashkëpunimit Ndërkombëtar:

- Rritja e bashkëpunimit me agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit për të ndarë informacionin, inteligjencën dhe praktikat më të mira në luftën kundër krimin të organizuar.

- Forcimi i partneriteteve globale është thelbësor për adresimin e rrjeteve kriminale transnacionale.

#### 2. Reformimi dhe Fuqizimi i Institucioneve Gjyqësore:

- Zbatimi i reformave gjithëpërfshirëse gjyqësore për të garantuar pavarësinë dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë.

- Fuqizimi i njësive të specializuara brenda gjyqësorit për të trajtuar rastet që lidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

#### 3. Procesi transparent i verifikimit:

- Sigurimi i një procesi transparent dhe të plotë verifikimi brenda agjencive të zbatimit të ligjit për të identifikuar dhe hequr individët e përfshirë në aktivitete kriminale. Transparenca ndërton besimin dhe besimin e publikut në integritetin e zbatimit të ligjit.

#### 4. Përmirësimet legislative:

- Rishikimi dhe forcimi i legjislacionit ekzistues për të adresuar sfidat e reja të paraqitura nga platformat e komunikimit të koduar.
- Krijimi i kornizave ligjore që lejojnë hetimin dhe ndjekjen efektive të aktiviteteve kriminale të lehtësuara nëpërmjet teknologjive të tilla.

#### 5. Përgjegjësia dhe mbikëqyrja:

- Krijimi i mekanizmave të fuqishme për mbikëqyrje dhe llogaridhënie brenda agjencive të zbatimit të ligjit.
- Organet e pavarura mbikëqyrëse duhet të monitorojnë sjelljen e punonjësve të policisë dhe të sigurojnë respektimin e standardeve etike dhe protokolleve ligjore.

#### 6. Ndërgjegjësimi dhe angazhimi publik:

- Rritja e ndërgjegjëimit të publikut për përpjekjet për të luftuar krimin e organizuar dhe rëndësinë e angazhimit të qytetarëve në raportimin e aktiviteteve të dyshimta. Komunitetet e informuara dhe të angazhuara kontribuojnë për një shoqëri më të sigurt.

#### 7. Mbrojtja e sinjalizuesit:

- Zbatimi i mekanizmave të fuqishëm të mbrojtjes së sinjalizuesve për të inkurajuar individët brenda organeve të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të tjera që të raportojnë korrupsionin dhe sjelljen kriminale pa frikën e hakmarrjes.

#### 8. Ngritja e Kapaciteteve dhe Trajnimi:

- Investoni në trajnimin e vazhdueshëm dhe ngritjen e kapaciteteve për personelin e zbatimit të ligjit. Pajisni ata me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të trajtuar sfidat në zhvillim të paraqitura nga rjetet e sofistikuar kriminale.

#### 9. Përvetësimi i Teknologjisë për Zbatimin e Ligjit:

- Përqafoni dhe integroni teknologjitë e avancuara për qëllime të zbatimit të ligjit, duke siguruar që hetuesit të kenë mjetet e nevojshme për të mbajtur hapin me përparimet teknologjike të përdorura nga kriminelët.

#### 10. Koordinimi ndërmjet agjencive:

- Rritja e koordinimit dhe komunikimit ndërmjet agjencive dhe institucioneve të ndryshme të zbatimit të ligjit. Bashkëpunimi efikas

është thelbësor për një qasje gjithëpërfshirëse dhe të unifikuar në trajtimin e krimit të organizuar.

#### 11. *Angazhimi i Shoqërisë Civile:*

- Të inkurajohet përfshirja aktive e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin dhe advokimin për reformat në sistemin e drejtësisë. Shoqëria civile mund të luajë një rol vendimtar në mbajtjen e institucioneve përgjegjëse dhe promovimin e transparencës.

#### 12. *Vlerësimi dhe përshtatja e rregullt:*

- Kryerja e vlerësimeve të rregullta të masave të zbatuara dhe përgatitja për të përshtatur strategjitë bazuar në natyrën në zhvillim të krimit të organizuar. Fleksibiliteti dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë thelbësore për të qëndruar përpara rrjeteve kriminale.

## Bibliografia

1. Europol: "Dismantling encrypted criminal EncroChat communications leads to over 6,500 arrests and close to EUR 900 million seized". [Link](#)
2. European Parliament: "ATAG - Artificial Intelligence in Criminal Law and its Use by the Police and Judicial Authorities". [Link](#)
3. Eurojust: "Dismantling Encrypted Criminal EncroChat Communications: 6,500 Arrests, 900 Million EUR Seized". [Link](#)
4. Gloucester Citizen: "The £3,000 a year encrypted mobiles with kill pills used by gangs". [Link](#)
5. Sot: "Dosjet e SPAK për përgjimet në "EncroChat" dhe "Sky"". [Link](#)
6. Shqiptarja.com: "Ballë: Policët që kanë pasur akses...". [Link](#)
7. Ligji nr. 128/2021: PËR AGJENCINË E MBIKËQYRJES POLICORE

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)